

AKT THEMELIMI

Shoqëria “Unique Pharmaceuticals” sh.p.k

Sot më datë 09/12/2022, une i nënshkruari **zj. Gjustina Loloçi** shtetase shqiptare, i datelindjes 06.11.1982, banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr I26106031P shpreh vullnetin tim për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “Unique Pharmaceuticals” sh.p.k si më poshtë vijon:

1. FORMA LIGJORE

“Unique Pharmaceuticals” sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

2. ORTAKET THEMELUES

Ortaku i vetem themelues i shoqërisë është Gjustina Loloçi.

3. OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “Unique Pharmaceuticals” sh.p.k. është “Aktivitet tregtar ne fushen e shendetesise, dermo-kozmetikes dhe ushqimit. Ekspertize dhe aktivitet ne fushen e zhvillimit rregullator dhe marketimit per barnat qe perdoren ne njerez, per pajisjet mjeksore, per suplementet ushqimore, fitopreparatet, produkte e higjenes dhe produktet dermo-kozmetike”, me qarte si me poshte:

1. Aktivitet tregtar import, eksport dhe shitje me shumice dhe pakice ne fushen barnave qe perdoren per njerezit, barna dhe materiale qe perdoren ne stomatologji, pajisjet mjeksore e aksesore te tyre dhe pajisje diagnostikues dhe laboratorike ne shendetesi per njerezit.
2. Aktivitet tregtar import, eksport dhe shitje ne fushen e suplementeve ushqimore, fitopreparateve qe perdoren per njerezit, pajisjet mjeksore dhe pajisjet diagnostikuese ne shendetesi per njerezit.
3. Aktivitet tregtar import export dhe shitje ne fushen e produkteve te higjenes dhe produkteve kozmetike dhe dermoestetike.
4. Sisteme dhe trajnime per sigurimin e pajtueshmerise ligjore dhe administrative (compliance).
5. Sherbime te promovimit dhe marketimit te produkteve farmaceutike humane, pajisjeve mjeksore, suplementeve ushqimore dhe kozmetike.
6. Ekspertize, konsulta dhe sherbime per regjistrimin e produktit farmaceutik dhe pajisjeve mjeksore.
7. Ekspertize, konsulta dhe sherbime per notifikimet e nevojshme per produktet si suplemente ushqimore, dhe kozmetike.
8. Ekspertize dhe sherbime per Farmakovigilencen dhe sigurine e barit lokalisht.
9. Sisteme per sigurimin e cilesise ne prodhim, ne ruajtje, per marketim dhe tregtim te produkteve.

Shoqëria mund të kryej edhe veprimtari të tjera të cilat janë të lidhura ngushtë me objektin e saj parashikuar me siper.”

4. SELIA

Selia e shoqërisë tregtare “**Unique Pharmaceuticals**” sh.p.k është në adresën: Njesia me nr. Pasurie 368/6+1-N2, Rruga 3 Deshmoret ,ZK:3866 , Yzberisht , Tirane.

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

gjustinaloloci@hotmail.com

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë dhe të zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. KOHËZGJATJA

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në paragrafin 1, të ketij neni mund të shkurtohet me vendim të Asamblese se Ortakeve të shoqërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Statuti i shoqërisë.

6. KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “**Unique Pharmaceuticals**” sh.p.k. është 100.000 (Njëqind mijë) leke i perfaqësuar nga 1 kuote , vlera nominale e të ciles eshte 100.000 (Njëqind mijë) leke Ortaket i vetem eshte zoterues i kuotes qe perfaqeson 100 % te kapitalit te shoqerise .

Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.

Kuota përfaqëson të drejtën e një votë.

7. ORTAKET

Ortaket i ushtrojne kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakeve.

8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

- Shoqëria drejtohet nga 1(nje) Administrator.
- Administratori i shoqërisë “**Unique Pharmaceuticals**” sh.p.k do të jete zj. **Gjustina Loloçi**
- Administratori emërohet me Vendim të Asamblese se Ortakeve, për një periudhë jo më shumë se 5 (pese) vjet me të drejtë ripërtëritjeje.
- Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**Unique Pharmaceuticals**” sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe statuti, i përket administratorit të saj. Ai ka

të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkoje për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

9. SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

THEMELUESI

Gjustina Loloçi

GJUSTINA LOLOÇI

